



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:101082
Datë: 07.02.2024
Numri i dokumentit: 05294821

PA1.nr. 934/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Ferit Osmani, anëtarë, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi, si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të akuzuarit M.D., nga Mitrovica, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, për të vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr. 306/2022 të datës 18.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 11 janar 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit M.D., ndersa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr. 306/2022 të datës 18.04.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr. 306/2022 të datës 18.04.2023, i akuzuari M.D., është shpallur fajtor për shkak të veprës Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar dënimi me gjobe në shumë prej 500 (pesëqind) euro e të cilën gjobe është obliguar që ta paguaje në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e shqiptuar me gjobe, i njëjti do t'i zëvendësohet në dënim me burgim kur për çdo 20 euro të gjobës do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim.

I akuzuari është obliguar që të paguaje shpenzimet e procedurës penale të cilat dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 40 (katërdhjetë) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumen

prej 20 (njëzet) euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

Pala e dëmtuar – KEDS ne Mitrovicë për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar ne kontest te rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :

I akuzuari M.D., për shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale, vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, dhe shkeljes se ligjit penal, duke propozuar qe aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare te ndryshohet dhe i akuzuari ne mungese te provave te lirohet nga akuza apo aktgjykimi i gjykatës se shkalles se pare të anulohet dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u skjaruar përkitazi me ankesën e të akuzuarit M.D., me shkresën e vet PPA.II.nr. 971/23 të datës 02.08.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e te akuzuarit ta refuzoje si te pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës se shkalles se pare te vërtetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit ne pajtim me nenin 390 paragrafi 1 te KPPRK-se, ne te cilën prezantuan i akuzuari M.D., si dhe mbrojtësi i tij av.Kadri Osaj i autorizuar ne procesverbal ne seancën para kolegjit te Apelit si dhe përfaqësuesja e palës se dëmtuar KEDS – E.B., ndërsa palët e tjera munguan, andaj seanca e kolegjit u mbajt ne pajtim me nenin 390 paragrafi 4 te KPPRK-se. Mbrojtësi i të akuzuarit në tërësi mbeti pranë ankesës së ushtruar me shkrim nga ana e të akuzuarit dhe pas elaborimit të së njëjtës propozoi që ankesa të aprovohet si e bazuar. I akuzuari ne tërësi përkrahu fjalët e mbrojtësit se tij. Përfaqësuesja e palës se dëmtuar E.B., deklaroi se ushtron kerkese pasurore juridike dhe kërkon kompensimin e dëmit.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të të akuzuarit M.D., dhe gjeti se :

- Ankesa nuk është e bazuar.

Sa i përket shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale i akuzuari M.D., me ankesë pretendon se aktgjykimi shkalles se pare është i përfshire me shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 pika 1.12 e lidhur me nenin 369 pika 2.7 te KPPRK-se, me arsyetim se dispozitivi i aktgjykimit është kundërthënës mes veti dhe me arsyet e paraqitura ne arsyetimin e aktgjykimit dhe me shkresat e lendes. Pretendon se dispozitivi i aktgjykimit është kundërthënës dhe i pakuptueshëm me brendinë e tij dhe arsyet e aktgjykimit. Gjithashtu, pretendon se Gjykata e shkalles se pare ne aktgjykimin e kundërshtuar nuk ka paraqitur arsyet për secilën pike veç e veç, nuk ka dhënë arsye lidhur me pretendimet e mbrojtjes në këtë çështje penale dhe nuk ka përshkruar veprimet inkriminuese së të akuzuarit duke mos i specifikuar te njejtat, e të cilat shkelje aktgjykimin e shkalles se pare e bëjnë te paqëndrueshëm për çka të njëjtin duhet anuluar. Gjithashtu pretendon se gjykata e shkalles se parë aktgjykimin e ka bazuar ne prova te papranueshme ne kundërshtim me nenin 257 të KPPRK-së duke e bazuar fajësinë kryesisht ne deklaratë e punëtorëve të KEDS-it dhe se këto prova nuk ka mbështetje ne asnjë provë tjetër relevante, janë kundërthënëse dhe kundërligjore, gjithashtu edhe nga fakti se kontrolli nga ana e

punëtorëve të KEDS-it është zbatuar pa urdhër nga ana e gjyqtarit kompetent, e duke vepruar në këtë mënyrë gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e bëjnë të paqëndrueshëm për çka të njëjtin duhet anuluar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore të të akuzuarit lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe konstatoi se të njëjtat nuk janë të bazuara ngase aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm dhe si i tillë përmban arsye të mjaftueshme përkitazi me faktet relevante të kësaj çështje juridiko penale si dhe faktet nga të cilat varet edhe aplikimi i drejte i dispozitave të ligjit penal. Theksimet e lartpërmendura në ankese nuk janë të natyrës së tillë për të konstatuar se aktgjykimi përmban mangësi të atilla procedurale që do ta bënin të paqëndrueshëm ligjshmërinë e tij. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejte dhe të plotë i ka vërtetuar të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje dhe se është mbështetur në provat e administruara si dëgjimin e dëshmitarëve A.H., A.H.1 dhe F.H., që të tre punëtorë të KEDS-it e të cilët në shqyrtimin gjyqësor të datës 21.03.2023, të cilët kanë deklaruar se gjatë kontrollimit në autolarjen në Mitrovicë në rrugën "Xhafer Deva", kanë konstatuar se e njëjta nuk ka pasur një sor elektrik dhe se për këtë kanë hartuar procesverbal dhe se emrin e të akuzuarit M.D., e ka marrë policia dhe se atë e kanë shkruar në bazë të asaj që atyre iu është thënë nga policia, andaj Gjykata e Apelit i refuzoi pretendimet ankimore si të pabazuara.

Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, i akuzuari pretendon se si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal në dem të të akuzuarit ka ardhur deri të vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ngase nuk është vërtetuar fakti se i akuzuari të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor, siç është pretenduar në aktakuzë e që këto fakte nuk janë vërtetuar as pas administrimit të provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve andaj gjykata sipas të akuzuarit e ka shpallur fajtor pa u plotësuar elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar dhe se nuk është vërtetuar se M.D., ka punuar me autolarje me datë 04.12.2020 dhe se ka të regjistruar ndonjë biznes të autolarjes.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore të të akuzuarit lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe konstatoi se të njëjtat nuk janë të bazuara ngase janë në kundërshtim me provat e administruara si dëgjimin e dëshmitarëve A.H., A.H.1 dhe F.H., pastaj procesverbali i datës 04.12.2020 ku dëshmitaret e kanë shkruar emrin e të akuzuarit si pronar i autolarjes duke u bazuar në atë që iu është thënë nga policia pasi që atë ditë nën asistencën e policisë për vendosjen e një sorit të konsumatorit dhe emri i konsumatorit ishte marrë nga policia dhe kane konfirmuar se konsumatori ishte i kyçur pa një sor elektrik, e në bazë të të cilave konstatohet se Gjykatës së shkallës së parë, drejte dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike në rastin konkret, andaj edhe pretendimet ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike i refuzoi si të pabazuara si dhe konstatoi se në rastin konkret kur i akuzuari është shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, drejte është aplikuar edhe ligji penal, për çka është pretendimet e të akuzuarit lidhur me shkeljen e ligjit penal në dem të të akuzuarit i refuzoi si të pabazuara ngase në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor dhe gjykuar.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, i akuzuari, me ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë është dashur që të akuzuarit ta liroj nga akuza në mungesë të provave, andaj

edhe vendimi mbi shqiptimin e dënimit me gjobe është ne kundërshtim me ligjin e gjithashtu edhe ne rast se konstaton Gjykata e Apelit se i akuzuari e ka kryer veprën penale dënimi i shqiptuar eshte shume i lartë duke pasur parasysh se i akuzuari eshte mbajtës i familjes, baba i 4 fëmijëve dhe jeton nga asistenca sociale.

Gjykata e Apelit konstatoi se gjykata e shkalles se pare me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal i ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së e te cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, andaj e refuzoi si ta pabazuar ankesën e te akuzuarit edhe lidhur me këtë bazë ankimore duke vërtetuar aktgjykimin e ankimuar te gjykatës se shkalles se pare e me bindje se me dënimin e shqiptuar nga ana e Gjykatës se shkalles se pare, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tij, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.934/23 më 11.01.2024

Procesmbajtës
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit
Skender Çoçaj

Ferit Osmani
